



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM  
Nr. 11, datë 22. 02. 2022

**BLERJE E PASURISË SË PALUAJTSHME (Zyra ), ME NJË SIPERFAQE 84 M<sup>2</sup>  
PRONË PRIVATE, PËR USHTRIMIN E FUNKSIONEVE ADMINISTRATIVE, NGA  
BASHKIA SKRAPAR**

Këshilli i Bashkisë Skrapar në mbledhjen e datës 22.02.2022 ,mori në shqyrtim projekt aktin e hartuar në zbatim të Ligjit 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, Kodi Civil në Republikën e Shqipërisë “, Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM-së Nr.89, data 03.02.2016, “Për miratimin e Hartës së Vlerës së Tokës në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Bashkia Skrapar

**VENDOSI:**

1. Blerjen e pasurisë së paluajtshme, Zyra pronë private, me një sipërfaqes 84 m<sup>2</sup>, për nevoja të Bashkisë Skrapar .
2. Bashkia Skrapar të përdorë pasurinë e mësipërme për ushtrimin e detyrave të saj institucionale dhe funksionale, të përcaktuara sipas akteve ligjore .
3. Vlera financiare për blerjen e kësaj pasurie në shumën 3,045 271 (tre milion e dyzet e pesë mijë e dyqind e shtatëdhjeta e një) lekë, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Skrapar, zëri “ investime“.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave.
5. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Skrapar, ose personi i autorizuar prej tij, për lidhjen e kontratës së shitblerjes së pasurisë para noterit.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të pikës 6, të nenit 55,të Ligjit 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”,

Vendimi u miratua me 8 vota pro, votë kundër – s’ka,votë abstenim- s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.



**KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK**  
Edlira SHKËMBI